Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 727
DAT.DT. 09.12.2020
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 261/2020
Datë: 18 nëntor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Alban Ajvazi, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/25/2020/GJTHPR-AD/GJTHPR/10/20, të datës 28 korrik 2020, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 18 nëntor 2020, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 19 dhe 20, të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Alban Ajvazi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragraf 1, nën paragraf 1.2, dhe neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.92/2020, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljen e pretenduar disiplinore të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Alban Ajvazi, i cili dyshohet se derisa ka mbajtur seancën dëgjimore në lëndën penale PP.nr.101/20, ndaj të pandehurit Milaim Demiri, i cili dyshohej se ka kryer vepër penale të dhunës në familje nga neni 248 të KPPK-së me datë 05.02.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përveç prokurorit me telefon ka ftuar edhe të dëmtuarën Marigona Muqaj, veprime këto që bien në kundërshtim me dispozitat e nenit 188, paragrafi 3, të KPPK.

Këto veprime të ndërmarra nga subjekti i hetimit nga parashtruesi i ankesës dhe Autoriteti Kompetent janë konsideruar shkelje disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragraf 1, nën paragraf 1.2, dhe neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për të shqyrtuar këtë çështje Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 18 nëntor 2020 ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën morën pjesë Kryesuesja e panelit hetimor Gordana Vlašković dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Alban Ajvazi.

Kryesuesja e panelit hetimor në fillim të seancës dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron pran raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura dhe ka kërkuar nga KGJK qe të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga gjyqtari Alban Ajvazi gjatë procedimit të lëndës PP.nr.101/20.

Gjyqtari Alban Ajvazi, në seancën dëgjimore ka deklaruar se gjatë seancës për caktimin e paraburgimit në lëndën PP.nr.101/2020, nuk ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragraf 1, nën paragraf 1.2, dhe neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ka shtuar se arsyeje se të dëmtuarën e a ftuar në seancë pasi qe deklarata e saj ka qenë e pakuptueshme, kjo nga fakti se incidenti kishte ndodhur në nëntor 2019, ndërsa ishte denoncuar në polici nga e dëmtuara pas katër muajve, ndërsa i pandehuri për shkak të dhunës në familje ishte arrestuar me datë 03.02.2020. Ka theksuar se në shkresat e lëndës kanë ekzistuar edhe disa fotografi në të cilat ishte e dëmtuara me disa lëndime të pretenduara. I ballafaquar me këto kundërthënie, ka vlerësuar se pjesëmarrja e të dëmtuarës ka qenë e domosdoshme për të ditë se si të veproj me tutje rreth masës ndaj të pandehurit. Ka shtuar se ky vendim është atakua dhe i njëjti në tërësi është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës.

Për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, KGJK administroj provat materiale siç janë: Raporti mbi provat dhe faktet e mbledhura gjatë procedurës hetimore i datës 28 korrik 2020, kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor e datës 18 maj 2020, shkresat e lëndës penale PP.nr.101/2020, vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.I-D.nr.156/2020, i datës 12.02.2020, procesverbalin nga seanca dëgjimore të datës 05.02.2020, i përpiluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK-ja vlerësoj se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se gjyqtari Ajvazi, në seancën për caktimin e paraburgimit në lëndën PP.nr.101/2020, të datës 05.02.2020, nuk ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 5,, paragraf 1, nën paragraf 1.2, dhe neni 5, paragrafi 2, nen paragrafi 2.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga provat e prezantuara nga Kryesuesi i Panelit Hetimor, përkatësisht nga shkresat e lëndës penale DKR.P.nr.43/2011, nuk u vërtetua se gjyqtari Alban Ajvazi gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në lëndën penale PP.nr.101/2020 të ketë bërë ndonjë shkelje disiplinore të sanksionuar me Ligjin mbi Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. KGJK, vlerëson se aplikimi i gabuar dhe jo i drejte i të drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës se pakënaqur në Gjykatën e instancës më të lartë. Kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbej si kriter në vlerësimin e performances së gjyqtarit të caktuar por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit, siç ka pretenduar Autoriteti kompetent.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.261/2020, datë: 18 nëntor 2020

Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Aferdita Bytyqi,, Kryetare, Gjykata Themelore në Prishtinë;*
- *Alban Ajvazi, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë;*
- *Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;*
- *Arkivit.*